

Projekti:

“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”

Implementues i projektit:

Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB Kosova)

Financuar nga:

Qeveria Suedeze



MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Rreth zbatimit të brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat e përbashkëta të trashëgimisë kulturore.

Në mes të



Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHWB Kosova) si implementues të projektit

Dhe



Komuna e Deçanit



Komuna e Gjakovës



Komuna e Istogut



Komuna e Junikut



Komuna e Klinës



Komuna e Pejës



1. Subjekti i Memorandumit

Ky Memorandum Mirëkuptimi (MM) vendoset dhe hyn në fuqi nga dhe ndërmjet partnerëve implementues të projektit: Fondacionit Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) me numër të regjistrimit 5200385-7 (referuar si Koordinator të Projektit), Komunës së Deçanit, Komunës së Gjakovës, Komunës së Istogut, Komunës së Junikut, Komunës së Klinës dhe Komunës së Pejës (tani e tutje të referuar si Palët) për zbatimin e brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat e përbashkëta të trashëgimisë kulturore. (tani e tutje referuar si Projekti).

2. Projekti

Sfondi

Fondacioni Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova) në bashkëpunim me gjashtë (6) komunitet e rajonit ekonomik perëndim (Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë, Pejë) po punojnë drejt zbatimit të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Rajonit Ekonomik Perëndim përmes Trashëgimisë Kulturore 2020-2023. Veprimet dhe aktivitetet e parapara përmes këtij dokumenti tentojnë të ripozicionojnë rolin e kulturës për rajonin ekonomik perëndim në zhvillimin gjithëpërfshirës përmes bashkëpunimit multi-sektoral ndër-komunal. Objektivi Specifik 1, përkatësisht "Ruajtja e integritetit dhe autenticitetit të aseteve të trashëgimisë kulturore" parashihet të arrihet përmes një sërë veprimesh, ndër to është listuar "Krijimi i brendit rajonal me përfshirje të identitetit vizuel dhe aktiviteteve promovuese dhe vetëdijësuese". Brendimi rajonal është një nga mënyrat për promovim të rajonit duke u bazuar në potencialet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e kulturor.

Qëllimi i përgjithshëm

Me realizimin e aktiviteteve të parapara me brendimin e rajonit parashihet ngritja e numrit të vizitorëve në lokacionet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në rajonin ekonomik perëndim si dhe fuqizimi dhe ngritja e ekonomive familjare të rajonit duke kontribuar në krijimin e një modeli të vetqëndrueshëm ekonomik rajonal të bazuar në kulturë e trashëgimi kulturore.

Objektivat specifike janë:

- Të kontribuojë në ndërtimin, menaxhimin dhe përmirësimin e imazhit të rajonit ekonomik perëndim përmes prezantimit të karakteristikave të kulturës e trashëgimisë bazuar në perceptimet e komunitetit dhe gjendjes faktike.

- Të nxisë bashkëpunimin rajonal institucional dhe brenda komunitetit në fushën e kulturës.
- Të inkurajojë bizneset vendore dhe ndërkombëtare dhe investitorët potencial të promovojnë produktet e tyre përmes identitetit pamor të propozuar që bazohet në lidhjet vizuale e emocionale me lokacionin e rajonit ekonomik perëndim.

Rezultatet e pritura janë:

- Shndërrimi i identitetit vizuel në markën turistike të rajonit;
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe krijimi i kalendarit të përbashkët kulturor;
- Rritja e investimeve në kulturë e trashëgimi;
- Rritja e vizitorëve vendorë dhe ndërkombëtar;
- Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të rajonit;
- Promovimi i produkteve ushqimore karakteristike të zonës;
- Promovimi i zejeve tradicionale;
- Promovimi i kulturës, artit dhe organizatave kulturore të rajonit;
- Promovimi i aktiviteteve kulturore dhe festivaleve.

3. Qëllimet e Palëve

Duke u bazuar në objektivat e mësipërme dhe rezultatet e pritura të Projektit.

Palët pajtohen që të punojnë së bashku në implementimin e Projektit në mënyrë që të fokusohen në objektivat e projektit, përfshirë këtu edhe palët e tjera relevante.

4. Përgjegjësitë e Palëve

4.1 CHwB Kosova si Koordinator i Projektit do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të siguroj mbarëvajtjen e përgjithshme të projektit. Të zbatojë Projektin me kujdesin, efikasitetin, transparencën dhe zellin e kërkuar, në përputhje me parimin e menaxhimit të shëndoshë financiar dhe me praktikat më të mira në fushë;
- Të ofroj ekspertizën e saj organizative dhe profesionale gjatë implementimit të Projektit;
- Të financoj, prokuroj dhe menaxhoj punën e krijimit të identitetit vizuel të brendit;
- Të ndajë me secilën komunë udhërrëfyesin e brendit rajonal;

- Të siguroj një sasi fillestare të materialeve promovuese me identitetin pamor të brendit për secilën komunë;
- Të siguroj një numër të caktuar të etiketave për produkte ushqimore për bizneset joformale nga secila komunë të cilat i plotësojnë kushtet e brendit (Aneks 1);
- Të prodhoj dhe montoj një numër të caktuar të paneleve interpretuese për asetet e trashëgimisë kulturore për secilën komunë;
- Të krijojë kanale të vecanta në rrjete sociale për brendin rajonal dhe ti mirëmbaj ato për një periudhë prej 12 muaj.

4.2 Secila nga komunat partnere në Projekt do të kenë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të aplikoj udhërrëfyesin për identitetin pamor të brendit rajonal, në ngjarjet kulturore të organizuara nga Komuna;
- Të aplikoj udhërrëfyesin për identitetin pamor në shenjzim, materiale të shtypura e mallëra;
- Të arrij marrëveshje me OJQ-të lokale të cilat realizojnë aktivitete me qëllim të promovimit të produkteve, kulturës e traditës që të aplikojnë udhërrëfyesin për identitetin pamor të brendit rajonal në aktivitetet dhe eventet e tyre;
- Të krijoj një modul të veçant në uebfaqen zyrtare të Komunës ku do të ngarkohen dokumentet e brendit rajonal dhe udhërrëfyesit e zbatimit të brendit;
- Të identifikoj lokalet e gastronomisë të cilat shesin produkte karakteristike të rajonit dhe ti shpërndaj te ata "etiketat" e brendit rajonal;
- Të identifikoj të gjitha pikat grumbulluese funksionale në rajon dhe të inicoj bashkëpunim më këto entitete, me aplikim të brendit rajonal;
- Në rastet kur Komuna përkatëse zbaton program zhvillimor dhe ndanë grante apo subvencione do të merr parasysh biznese prodhuese dhe shërbyese, si dhe biznese të industrive kreative¹ të cilët i plotësojnë kushtet për ta përdorur brendin rajonal (Aneks I);
- Në bazë të hulumtimit të tregut lokal, të propozojë listën e prodhuesve jo formal të produkteve ushqimore të cilët i plotësojnë kushtet e brendit që të

¹ Industritë kreative janë ato industri që kanë origjinën e tyre në krijimtarinë, aftësitë dhe talentin individual dhe që kanë potencial për zhvillim ekonomik dhe krijim të vendeve të punës përmes gjenerimit dhe shfrytëzimit të pronës intelektuale. Burimi: DCMS (2001), Creative Industries Mapping Document 2001 (2 ed.), London, UK: Department of Culture, Media and Sport (*Dokumenti i Shenjimit të Industrive Kreative 2001, edicioni i 2-të, Londër, BM, Departamenti për Kulturë, Media dhe Sport*)

furnizohen me etiketa të produkteve. Të bëjnë shpërndarjen e etiketave te prodhuesit e zgjedhur brenda komunës;

- Të promovoj brendin rajonal në kanalet e mediave sociale të komunës sipas kritereve të udhërrëfyesit;
- Të marrin pjesë në programe televizive dhe radio për kampanjën promovuese të brendit;
- Bashkarisht gjashtë (6) komunat të organizojnë një punëtori me asociacionet e bleshkatarëve dhe aktiviteteve tjera rekreative të rajonit për aplikimin e identitetit pamor të brendit në aktivitetet e këtyre shoqatave;
- Kontributet e tjera, të cilat nuk përfshihen në kontributin financiar mund të jenë logjistike, teknike apo çfarëdo lloj tjetër kontributi;
- Të ndihmojë në qëndrueshmërinë e Projektit dhe zbatimin e aktiviteteve brenda Projektit.

5. Ndarja e informative me palë të treta

Pas marrëveshjes së dyanshme me shkrim, Palët mund t'u japin palëve të treta raporte zyrtare dhe informata të tjera nga aktivitetet që dalin nga ky MM, përpos nëse pala e tretë është Qeveria Suedeze, në të cilin rast Koordinatori i Projektit në çdo kohë mund ti ndaj të gjitha raportet e lidhura me aktivitetet në këtë MM me Qeverinë Suedeze si Donator kryesor të projektit.

6. Pajtueshmëria me ligjin

6.1 Ky MM do të implementohet në pajtim me ligjet në Republikën e Kosovës.

6.2 Ky MM nuk do të jetë në kundërshtim me asnjë marrëveshje bashkëpunimi që Palët kanë me palë të treta.

7. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

7. Palët do të zgjidhin në mënyrë miqësore, me bisedime, të gjitha mosmarrëveshjet, kundërthëniet apo ankesat që dalin apo janë të lidhura me këtë MM.

8. Tërheqja e Palëve nga Projekti

8.1 Nëse njëra nga Palët argumenton mos zbatimin e këtij Memorandumi, dhe atë vetëm pas konsultimeve paraprake me CHwB Kosova, atëherë ajo palë mund të tërhiqet nga Projekti.

8.2 Në rast se komuna partnere dëshmoheq që nuk i plotëson obligimet e këtij Memorandumi, kjo dhe pas konsultimeve shtesë me Kryetarin përkatës të Komunës, CHWB Kosova mban të drejtën të tërheqë projektin nga komuna përkatëse dhe ti ofroj bashkëpunim një komune tjetër.

9. Amandamenti

9. Palët, munden me marrëveshje të dyanshme me shkrim të amandamentojnë këtë MM.

10. Përpilimi dhe përkthimi

10.1 Ky MM është i përpiluar në një (1) ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe për cdo Palë. Secila Palë do ta ketë një (1) ekzemplar origjinal në gjuhën Shqipe të nënshkruar.

11. Hyrja në fuqi dhe përfundimi i marrëveshjes

11.1 Ky MM do të hyj në fuqi ditën e nënshkrimit nga Palët nënshkruese.

11.2 Anekset janë pjesë integrale e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

11.3 Ky MM do të implementohet deri në datën 1 gusht 2023.

Memorandumi i Mirëkuptimit nënshkruhet në shtatë (7) ekzemplarë, në gjuhën shqipe me tekste autentike.

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për CHwB Kosova

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Sali Shoshi
Drejtor i CHwB Kosova

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Pejës

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Gazmend Muhaxheri
Kryetar i Komunës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Gjakovës

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Ardian Gjini
Kryetar i Komunës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Istogut

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Ilir Ferati
Kryetar i Komunës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Klinës


Nënshkrimi, vija dhe data

z. Zenun Elezaj
Kryetar i Komunës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Deçanit

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Bashkim Ramosaj
Kryetar i Komunës

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NË MES TË CHwB Kosova DHE KOMUNAVE
TË RAJONIT PERËNDIMOR TË KOSOVËS**

**Rreth implementimit të projektit
“Zbatimi i brendit rajonal për rajonin ekonomik perëndim, i bazuar në vlerat
e përbashkëta të trashëgimisë kulturore”**

Për Komunën e Junikut

Nënshkrimi, vula dhe data

z. Ruzhdi Shehu
Kryetar i Komunës